


## AKT-THEMELIMI

### I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2004, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me ligjet perkatese, Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

#### V E N D O S I:

- 1- Te krijohet Shoqerine Anonime "Ujesjelles Fshat" Sh.a. Shkoder me kapital 100% shtetoror.
- 2- Objekti i Shoqerise eshte: Prodhimi dhe furnizimi me uje te pijshem i popullates se fshatrave te rrethit Shkoder.
- 3- Shoqeria do te kete seline e saj ne Shkoder dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
- 4- Kapitali themeltar eshte 531,900,000 leke ndare ne 531,900 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.
- 5- Shoqeria ka nje zgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
- 6- Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:  
Z. Arben Rexhepi  
Znj. Lindita Radovani  
Znj. Manjola Lesha
- 7- Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
- 8- Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

  
Mr. QIKO  
Z V MINISTRI









## NDËRMARRJA "UJËSJELLËSIT FSHAT" SH.A.SHKODËR

Adresa : Lagja "Tom Kola", Rruga "Bashkimi", Shkodër TEL. 0224 37-75

Nr. 274 Prot.

Shkodër, me 3 10 / 2011

Mbledhje e jashtëzakonshme e Kryetareve të Këshilla Komunal.

Drejtuar : Kryetarit te Keshillit Mbikqyres. Z Ahmet Omi

Drejtuar : Kryetarit te Keshillit : Berdice

Hajmel

Velipoje

Rrethina

Ana e Malit

Shale

Gure i Zi

Të nderuar zotërinj në bazë të Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Neni 6/Pika 2 e Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE", "Organi përfaqësues i komunës ose bashkisë është këshilli komunal ose bashkiak.", si dhe në bazë të pikës 7 të Udhëzimit Nr 965 date 11.12.2007 për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës kanalizime në njësinë e qeverisjes vendore", ju njoftoj se me datën 24/08/2011 orën 10.00 do të zhvillohet mbledhja e Kryetarëve të Këshillave Komunal me rëndin e ditës si më poshtë:

Rendi i ditës

Rikonfirmimi i Anëtarëve të Asamblesë dhe hartimi i Statutit te Shoqerise

Njoftimi të bëhet me shkrim ose me komunikimin direkt të të gjithë Kryetarve të Këshillave Komunal.

Drejtori  
Flauers SHOSHI



## NDËRMARRJA "UJËSJELLËSIT FSHAT" SH.A. SHKODËR

Adresa : Lagja "Tom Kola", Rruga "Bashkimi", Shkodër TEL. 0224 37-75

Nr. 287 Prot.

Shkodër, me 24/10/2011

### Proces - Verbal

Sot me dt 24/10/2011, në orën 10:00 ne Seline e Ndermarrjes se Ujesjellsit Fshat Shkoder mbahet mbledhja e Kryetareve te Keshillave Komunale dhe hyn ne proces votimi i parashikuar ne rendin e dites per votbesimin e anetareve te asamblese.

### Anetaret e Asamblese

Lic Elezi

Nikoll Marku

Lazer Ilia

Dritan Hoti

Besim Suka

Martin Marku

Leke Bibaj

### Konfirmohen nga Kryetarët e Këshillave Komunale

Per Komunen Hajmel

*Benard Malini*  
*[Signature]*

Per Komunen Ana e Malit

*Fatmir Mehmeti*  
*[Signature]*

Per Komunen Rrethina

*[Signature]*  
*[Signature]*

*... ne prezencë*

*[Signature]*  
*[Signature]*  
*[Signature]*

Per Komunen Gure i Zi

*[Signature]*  
*[Signature]*

Per Komunen Shale

*Nikoll Platko*  
*[Signature]*

Per Komunen Velipoje

*Anton Marku*  
*[Signature]*

Per Komunen Berdise

*Muzaferr Meta*  
*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*  
*[Signature]*





## NDËRMARRJA "UJËSJELLËSIT FSHAT" SH.A.SHKODËR

*Adresa : Lagja " Tom Kola ", Rruga " Bashkimi ", Shkodër TEL. 0224 37-75*

Nr. 28 Prot.

Shkodër, me 24/02 2011

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është statuti i shoqërisë;
- "Aksionarë" janë personat emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve;
- "Ditë të Plota" në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

### Kreu I

#### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit**

##### **Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Në mbështetje të vullnetit të aksionerëve themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", themelohet Shoqëria Tregtare "Ndermarrja Ujësjellës Fshat" SH.A, e cila do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe këtij statuti.

##### **Neni 2: Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm Shitjen e Ujit tek konsumatori.

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë : Pa afat.

### **Neni 4: Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike**

(1) Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: L: “Toma Kola” Rr: Bashkimi (mbrapa Shkollës “Jordan Misja” Shkodër.

(2) Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është:

(3) Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

## **Kreu II**

### **Kapitali i Regjistruar**

#### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 410.600.600,00 Lekë, i ndarë në 410.600,00 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000,00 secili. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

1. Aksionari themelues : Komuna Shale

Iloji i kontributit: Kontributi ne para  
numri i aksioneve 29.973,80 dhe vlera e aksioneve:  
; vlera e kontributit: 29.973.800

2. Aksionari themelues : Komuna Ana E Malit

Iloji i kontributit: Kontributi ne para, numri i aksioneve 34.901,00 dhe vlera e aksioneve;  
vlera e kontributit: 37.901.000,00

3. Aksionari themelues : Komuna Rrethina

Iloji i kontributit: kontributi ne para numri i aksioneve 134.266,20 dhe vlera e aksioneve ;  
vlera e kontributit: 134.266.200,00.

4. Aksionari themelues Komuna Berdise;



lloji i kontributit; Kontributi ne para numri i aksioneve 54.199,20dhe vlera e aksioneve ; vlera e kontributit 54.199.200,000

5. Aksionari Gur i Zi ;

lloji i kontributit; kontributi ne para; numri i aksioneve 69.391,40 dhe vlera e aksioneve ; vlera e kontributit 63.391.400,00

6.Aksionari themelues Komuna Velipoje

lloji i kontributit ;Kontributi ne para ; numri i aksioneve 50.093,20 dhe vlera e aksioneve ; vlera e kontributit 50.093.200,00

7. Aksionari themelues Komuna Hajmel

lloji i kontributit ;kontributi ne para; numri i aksioneve 37.775,20 dhe vlera e aksioneve; vlera e kontributit 37.775.200,00

Numri i përgjithshëm i aksioneve: 7

kapitali i regjistruar: 410.600.000,00

vlera e paguar:

(2) 25% e vlerës së kontributeve në para do të paguhet menjëherë. Kontributet në natyrë do të kalojnë për llogari të Shoqërisë përpara regjistrimit. Kontributet në natyrë të cilat do të kalojnë në dobi të Shoqërisë të sapokrijuar do të kryhen menjëherë pas regjistrimit në QKR.

(3) Pagesat e kontributeve në para do të kryhet në **llogarinë numër pranë** AI592055110602842601PBLCALLA **Bankës B.K.T.**

(4) Aksionarët themelues i drejtohen gjykatës kompetente sipas vendndodhjes të selisë së Shoqërisë për të caktuar një ekspert të pavarur të licencuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë. Raporti i ekspertit depozitohet në QKR së bashku me këtë statut.

**Neni 6: Kërkesa për të paguar aksionet dhe tërheqja e aksioneve të papaguara**

- (1) Administratori mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për aksionet e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- (2) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.
- (3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- (4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojnë paraprakisht të paktën tridhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast se moszbatimi të tij, pasojat ligjore do të jenë ato të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 124 të Ligjit.
- (5) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 124, aksioni me të cilin lidhet njoftimi mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- (6) Anulimi i aksionit sjell zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë, në përputhje me parashikimin e nenit 186 të Ligjit.
- (7) Personi, aksionet e të cilit janë anuluar, humbet cilësinë e aksionarit lidhur me këto aksione por do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky aksionar ndaj shoqërisë në datën e anulimit të aksioneve së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të aksioneve.

#### **Neni 7: Llojet e Aksioneve, Obligacioneve, të Drejtave dhe Kufizimeve**



(1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të aksionarëve.

(2) Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të kualifikuar votash, mund të vendosë emetimin e obligacioneve të cilat u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i kthyer në aksione ose të drejtën e parablerjes për aksionet (obligacionet e kthyeshme) dhe obligacionet që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e zotëruesve të tyre në ndarjen e fitimeve në dobi të aksionarëve (obligacionet me pjesëmarrje në fitim).

### **Neni 8: Certifikatat e aksioneve**

Secili aksionar, që zotëron aksione, ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase të zotëruara nga ai, me pagesën e një shume sipas aksioneve përkatëse, që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për aksionet e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të aksioneve, në përputhje me pikën 1 të nenit 121 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të renditen në certifikatën e aksionit. Në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 2 të nenit 117 të Ligjit.

### **Neni 9: Regjistri i aksioneve**

Administratori i mëposhtëm, i caktuar në pajtim me pikën 3 të nenit 18 të këtij Statuti, është përgjegjës për krijimin e funksionimin e regjistrit të aksioneve, në përputhje me nenin 119 të Ligjit, deri në momentin e emërimit nga Asambleja e Përgjithshme të Administratorit të ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve Z. Spartak Koxhia.

### **Neni 10: Kalimi me Kontratë i Aksioneve**

(1) Kontrata e kalimit të aksionit bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të Shoqërisë dhe do të zbatohet nga dhe për llogari të personit që kalon aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij dhe nga e për llogari të personit të cilit i kalohen aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij,

nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e aksioneve të shoqërisë në përputhje me nenin 119 të Ligjit.

### **Neni 11: Kalimi i aksioneve me Trashëgimi ose Falimentim**

(1) Nëse një aksionar vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të aksioneve, dhe përfaqësuesit e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gëzues i të drejtave mbi aksionin e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij statuti, pasuria e aksionarit të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me çdo aksion të bashkëzotëruar me persona të tjerë.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i aksionit ose të kërkojë regjistrimin e aksionit në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i aksionit. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i aksionit, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i aksionit, ai ia kalon aksionin me kontratë një personi tjetër.

(3) Personi që fiton të drejta mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari gëzon të drejtat që gëzonte zotëruesi i aksionit, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë ose mbledhjeve të posaçme të aksionarëve të çdo klase aksionesh, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë si zotërues i aksionit.

### **Neni 12: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

(1) Administratori/ët, deri në tre vjet nga data e themelimit të Shoqërisë, mund të rrisin kapitalin themeltar të Shoqërisë deri në shumën 30 % të aksioneve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, kjo e drejtë duhet të rinovohet me shumicën e kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh.

(3) Aksionet të cilat, në momentin e miratimit të vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, nuk janë pranuar ose nuk është rënë dakord të pranohen nga asnjë aksionar, mund të anulohen dhe kapitali themeltar zvogëlohet në përputhje me vlerën e aksioneve të anuluar.

(4) Ne pajtim me Ligjin, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me shumicën e kualifikuar së votave, të përcaktuara në fjalinë e dytë, pika 1, të këtij neni.

### Kreu III

#### Asambleja e Përgjithshme

##### **Neni 13: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori, të paktën dy herë në vit. Këshilli Mbikëqyrës mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara në nenin 136 të Ligjit. Administratori thërret menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rast se kërkohet nga aksionarët e përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 139 të Ligjit. Asambleja mbledhet në selinë e shoqërisë.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo aksionari, përfshirë edhe përfaqësuesin e aksioneve në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën njëzet e një ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen. Secilit aksionar, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numrat PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

(3) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

##### **Neni 14: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë. Në mbledhjet e aksionarëve përfaqësuesit e bashkive/komunave, paraqiten me autorizimin dhe qëndrimin për rendin e ditës të dhënë nga



këshilli komunal/bashkiak. Çdo përfaqësim pa këtë autorizim dhe qëndrimin përkatës të këshillit komunal/bashkiak është i pavlefshëm, parashikuar në Udhëzimin Nr 965 date 11.12.2007.

(2) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit. Aksionarët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 142 të Ligjit. Aksionarët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Këshilli Mbikëqyrës cakton një Administrator si Kryetar të mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose Administratori nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

(4) Administratori ose anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

(5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në pajtim me kuorumin e caktuar nga Ligji, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose

2. aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i aksionarit ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë aksionari.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një aksionari, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes, përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

### **Neni 15: Votat e Pjesëmarrësve**

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga aksionet, çdo aksion i jep aksionarit (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose aksionarit (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

(2) Asnjë aksioner nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme apo në mbledhjet e veçanta të zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me aksionet e zotëruara prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto aksione.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

### **Neni 16: Votimi me Prokurë**

(1) Përfaqësuesi do të emërohet nga një pjesëmarrës në mbledhje sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

“.....ShA..... Unë/Ne i/të nënshkruari/t, ....., në cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ....., ose në pamundësi të tij, ....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë. Nënshkruar më..... 20.....”.

(2) Në rastet kur dëshirohet tu jepet aksionarëve mundësia për ta udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët): “.....ShA..... Unë/Ne i/të nënshkruari/t, ....., ne cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ....., ose në pamundësi të tij, ....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë. Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 \*pro \*kundër

Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më..... 20.....”.

(3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

(4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 3, i këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### **Neni 17: Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar**

(1) Me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për tre vjet me radhë, në pajtim me shkronjën “ç”, pika 2 e nenit 135 të Ligjit. Emërimi behet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.



(2) Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për largimin ekspertëve kontabël të autorizuar.

(3) Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton Këshillit Mbikëqyrës në përputhje me pikën 3 të nenit 20 të këtij Statuti, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

(3) Z. Mimoza Memoci emërohen si Ekspertë Kontabël të Autorizuar deri në emërimin nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme sipas shkronjës “ç”, pika 2 e nenit 135 të Ligjit.

#### **Kreu IV** **Administratorët**

##### **Neni 18: Emërimi i Administratorëve**

(1) Administratorë të shoqërisë mund të jetë një ose disa persona fizikë. Ata emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet. Ata mund të rizgjidhen.

(2) Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit mbikëqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

(3) Këshilli Mbikëqyrës me propozim të Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të shkarkojë administratoren/ët për shkaqe të ligjshme.

(4) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si Administratorë. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 158 të Ligjit.

(5) Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i Shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë të Përgjithshme.

Administrator i Shoqërisë “Ndermarrja Ujësjetllës Fshat” Sh.A wshtw z. Flauers Shoshi, i cili ka qwnw administrator i shoqwrsw qw nga koha e emerimit nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikcionit nga viti 2006 e në vazhdim.

### **Neni 19: Kompetencat e Administratorëve**

(1) Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 167, shkronjave “a”, “gj”, “h” dhe “i” të pikës 1 të nenit 154, dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 158 të Ligjit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 167 dhe shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 të nenit 154 të Ligjit nuk mund t’iu delegohen Administratorëve.

(2) Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

### **Neni 20: Te drejtat dhe përgjegjësitë**

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

1. Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
2. Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave të shoqërisë;
4. Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
5. Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
6. Të raportojnë përpara këshillit mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
7. Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
8. Administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit mbikëqyrës në rastet kur:
  - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kerkueshme brenda 3 muajve në vijim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozohet blerja nga një aksionar e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë,

#### **Neni 21: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve**

(1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. Personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” përfshirë shkarkimin nga Këshilli Mbikqyrës me propozim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë,

#### **Neni 22: Përfaqësimi i shoqërisë**

Adminstarorët përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët. Administratorët të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 23: Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Adminstratorëve**

Adminsitorët dhe anëtarët e këshillit mbikqyrës detyrohen:

1. të kryejnë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;
2. të ushtrojnë kompetencat që u jep ligji dhe statuti;
3. të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
4. të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme të interesave personale me ata të shoqërisë;
5. të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Ata përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të



publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

## **Kreu V**

### **Këshilli Mbikëqyrës**

#### **Neni 24: Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron të paktën tre ose më shumë persona fizikë, gjithmonë në një numër tek jo më të madh se 21, në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në përputhje me shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 135, pikës 4 të nenit 167 dhe pikës 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontrate pune e lidhur me Shoqërinë.

(2) Nuk mund të zgjidhen në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorët e Shoqërisë dhe të shoqërive të të njëjtit grup apo personat e lidhur me ta në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 13 të Ligjit, si dhe nuk mund të veprojnë si antar të Këshillit Mbikëqyrës përfaqësuesit e aksionerëve në Asamblesë të Përgjithshme në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 140 të Ligjit. Si dhe duhet të referohemi edhe kufizimeve të tjera për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës parashikohen në nenin 156 të Ligjit.

(3) Shumica e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë të pavarur sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

(4) Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një person i cili dëshiron të ushtrojë detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës për të plotësuar një vend të lirë ose si një anëtar tjetër shtesë, me kusht që të mos tejkalohej numri i anëtarëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarit të emëruar në këtë mënyrë është deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit Mbikëqyrës deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

- Komuna Velipoje Z. Ahmet Omi
- Komuna Berdise Z. Engjell Gjondrekaj

- Komuna Gur i Zi Z. Zenun Murati
- Komuna Rrethina Z. Nadire Cenga,
- Komuna Rrethina Z. Edmond Hali
- Komuna Ana e Malit Znj. Kozeta Bruka
- Komuna Shale Znj. Kozeta Bruka
- Komuna Hajmel Znj. Kozeta Bruka

## **Neni 25: Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Komiteteve së tij**

(1) Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët dhe kontrollojnë pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit dhe të Statutit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 dhe pika 2 e nenit 154 të Ligjit nuk mund t’iu delegohen Administratorëve.

(2) Këshilli Mbikëqyrës mund t’ia delegojë kompetencat e veta një komiteti që përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Ky delegim mund të bëhet në përputhje me kushtet që mund të vendosen nga Këshilli Mbikëqyrës e mund të revokohet ose ndryshohet. Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të delegojë asnjë nga detyrat të cilat i ngarkohen në pajtim me dispozitat ligjore.

(3) Në përputhje me sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës krijon

1. një komitet i cili përcakton standardet për emërimin e Administratorëve nga Asambleja e Përgjithshme;
2. një komitet i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
3. një komitet për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të Shoqërisë.

Komitetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur.

(4) Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë nga Këshilli Mbikëqyrës. Qëllimi kryesor i komiteteve është rritja e efikasitetit të Këshillit Mbikëqyrës duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur si edhe të ndihmojnë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimmarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i komiteteve nuk

zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.

(5) Në veçanti, komiteti i kontrollit financiar:

1. mbikëqyr procesin e raportimit financiar;
2. mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve;
3. mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit;
4. shqyrton dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertëve kontabël të autorizuar ose të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.

(6) Bazuar në vendimet e komisioneve të tij, Këshilli Mbikëqyrës:

1. paraqet propozime Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me emërimin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
2. harton raportin mbi ecurinë e veprimtarisë sipas me nenit shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 154 të Ligjit dhe ia dorëzon atë Asamblesë së Përgjithshme sipas pikës 3 të nenit 137 të Ligjit;
3. harton raportin vjetor për drejtimin e brendshëm të shoqërisë dhe kualifikimin e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe e bën publik atë sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 134 të Ligjit.

(7) Asnjë ndryshim i Statutit dhe udhëzim i Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Këshillit Mbikëqyrës të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë udhëzimi.

### **Neni 26: Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

1. Këshilli Mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund ti kërkojë gjykatës të shkarkojë një anëtar në rastet e shkeljes së detyrave të parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
3. personi ndodhet në gjendje paafësie paguese;
4. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
5. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose



## **Neni 27: Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshhtësinë e këtyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.

(3) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njëjloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

## **Neni 28: Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit së Këshillit Mbikëqyrës mbi çështje për të cilat këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, ose që mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Zbatohet parashikimi i pikave 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.

(2) Vota e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk gëzon të drejtën e votës.

(3) Në rast se në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtari të tij, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

#### **Neni 29: Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës**

Këshillit Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

1. të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

#### **Neni 30: Shpërblimi i punës dhe shpenzimet e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të miratuar me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 160 të Ligjit.

(2) Përfitimet individuale përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Ato duhet të pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme detyrat e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni të statutit dhe gjendjen financiare të Shoqërisë.

(3) Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës mund të shpërndajë shpërblime në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata Administratorë ose anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë pasur detyra dhe kanë punuar më parë për Shoqërinë ose kanë pasur detyra në organe të saj, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe Këshilli Mbikëqyrës mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

(4) Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mund t'iu paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe shpenzime të tjera në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

### **Neni 31: Hetimet e posaçme dhe mbikëqyrja**

Çdo person ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit ose për të kërkuar nga Këshilli Mbikëqyrës që të kryejë detyrat e tij në rastet e veçanta të parashikuara nga pika 2 e nenit 166, dhe neni 165 i Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar i cili vërteton se ky/këta persona plotësojnë kushtet për të kryer këtë veprim.

## **Kreu VI**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 32: Dividendët**

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet

dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

### **Neni 33: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapita

## **Kreu VII**

### **Prishja dhe njoftimet**

#### **Neni 34: Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.







#### **Neni 35: Njoftimet**

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në pikën 3 të nenit 4 të këtij Statuti janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit ose në adresën apo postën elektronike e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.

(3) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga Shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të Shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti.

**Emrat dhe nënshkrimet e Aksionarëve Themelues:**

- 
- Lic Elezi ( Rrethina )  -
- Nikoll Marku ( Velipoje )  -
- Lazer Ilia ( Gure i Zi )  -
- Besim Suko ( Ana e Malit )  -
- Martin Marku ( k. Shale )  -
- Lek Bibaj ( Hajmel )  -
- Dritan Hoti ( Berdice )
- 
- 

Drejtor  
Flavio Shoshi  
  
